1. HYRJE

Një dekadë më parë, 15 vendeve të Europës Lindore e Qendrore iu desh të fillonin nga e para procesin e krijmit, ose të rikrijimit, të një sistemi financiar plotësisht funksional aty ku nuk kishte ekzistuar më parë, ose në rastin më të mirë, nuk kishte ekzistuar për të paktën 40 vitet e fundit. Ballafaqimi me shumë probleme në sistemet bankare ekzistuese bëri që këto vende të hynin në rrugën e reformimit të tyre. Duke hedhur një vështrim në dekadën që kaloi, vërehet se tre ishin hapat kryesorë në reformimin e sektorit financiar dhe bankar: (i) rivendosja e qëndrueshmërisë makroekonomike, përfshi arritjen e normave të ulëta të inflacionit; (ii) privatizimi i bankave si edhe i ndërmarrjeve, kliente të bankave; dhe (iii) hapja e dyerve për bankat e huaja[1].

Pra, një ndër drejtimet kryesore të këtij procesi ishte lejimi i hyrjes së kapitalit të huaj[2] në sistemin bankar ose nëpërmjet çeljes së bankave të huaja (degë, filiale, banka të përbashkëta, zyra përfaqësie) ose nëpërmjet privatizimit (totalisht apo pjesërisht) të bankave ekzistuese shtetërore. Të njëjtin model ndoqën edhe vendet e rajonit të Ballkanit ndonëse në një periudhë kohore disa vite më të vonshme.

Tashmë, kur kanë kaluar disa vite, në këto vende është rritur prania e kapitalit të huaj në sistemet bankare duke sjellë edhe zhvillimin e tyre, ndoshta jo në shkallën e pritshme. Nga ana tjetër, në këto vende po rritet shqetësimi për dominimin e sistemeve bankare krejtësisht ose në masë të madhe nga të huajt. Për pasojë, gjithnjë e më të fortë po bëhen zërat që ngrihen kundër politikave liberale të hyrjes së bankave të huaja në treg, privatizimit tek të huajt si dhe po bëhen thirrje për adoptimin e politikave proteksioniste në këtë sektor të ekonomisë.

---

[1] "*Starting from scratch*", revista "The Banker", October 1999, fq. 55.

[2] Për qëllime të këtij studimi termi "*bankë e huaj*" është përdorur si sinomin i termit "*bankë me kapital të huaj*". Gjithashtu, studimi interesohet për origjinën e kapitalit të huaj.

Kuptohet që kjo situatë është e ndryshme nga një vend të tjetrin pasi shkalla e hyrjes së kapitalit të huaj është e ndryshme. Për shembull, në dy vendet më të përparuara në tranzicion, Hungari dhe Poloni, është lejuar një hyrje e lartë e kapitalit të huaj në tregjet bankare[3]. Estonia ka vetëm gjashtë banka tregtare. Tre prej tyre posedohen nga të huajt, përfshi dhe dy bankat më të mëdha, të cilat zënë 85-90 për qind të aktiveve gjithsej të sistemit bankar. Bankat e huaja janë dominuese edhe në Letoni[4].

Tabela 1: Pronësia e huaj mbi bankat në Hungari e Poloni.

Treguesi	Hungaria	Polonia
Numri i bankave gjithsej	43	80
Numri i bankave ku shumicën e kapitalit e zotërojnë të huajt	30	34
Përqindja e kapitalit të huaj ndaj kapitalit të sistemit bankar	61	52

Burimi: Storf (2000). Të dhënat për Hungarinë janë të shtatorit 1999 dhe për Poloninë të mesit të vitit 1999.

Studimet më të fundit të Bank Austria Creditanstalt tregojnë që pesha e bankave të huaja në tregun bankar të Europës Lindore e Qendrore u rrit në 32 për qind vitin e fundit nga 20 për qind që ishte një vit më parë dhe kjo shifër do të rritet ende si pasojë e privatizimeve të mjaft bankave kryesore[5].

[3] Galac Tomislav, Kraft Evan, "*What has been the impact of foreign bank in Croatia?*", seria e vrojtimeve S-4, December 2000, botim i Bankës Kombëtare të Kroacisë, fq. 2.
[4] "*Starting from scratch*", revista "The Banker", October 1999, fq. 56.
[5] "*Survey finds foreign ownership is rising*", revista "The Banker", October 1999, fq. 53.

2. ARSYET PRO DHE KUNDËR HYRJES SË BANKAVE TË HUAJA

Teorikisht, arsyet pro dhe kundër hyrjes së bankave të huaja në një vend janë renditur tepër qartë në Bonin et al (1998)[6]. Në vija të përgjithshme këto arsye janë:

Arsyet pro hyrjes së bankave të huaja:

* *Novacioni në produkte dhe shërbime*. Bankat e huaja kanë aftësi të ofrojnë një llojshmëri më të gjerë produktesh dhe shërbimesh pasi e kanë ekspertizën e nevojshme qysh nga tregjet prej nga vinë. Ndërkohë, bankat vendase ose nuk kanë njohuritë e duhura për të prezantuar produkte e shërbime të reja ose gjendja e tyre (problemet e trashëguara) nuk i lejon të investojnë në këtë fushë.

* *Ekonomia e shkallës dhe fushës së veprimtarisë*. Për këtë çështje jepen dy argumente. Së pari, bankat e huaja mund të ofrojnë teknologjinë, e cila është shumë e nevojshme për bankat e mëdha vendase për sigurimin e përfitimeve, që sjell ekonomia e shkallës. Por, bankat e huaja do ta ofrojnë këtë përfitim vetëm nëse ato arrijnë të blejnë shumicën e aksioneve në një bankë vendase. Së dyti, bankat e huaja mund të nxisin konsolidimin e sistemit bankar duke marrë pjesë në procesin e bashkimeve apo të blerjeve të bankave më të vogla vendase. Gjithashtu, bankat e huaja sigurojnë përfitimet, që ofron ekonomia e fushës së veprimtarisë nëpërmjet njohurive që ato kanë për veprimtari të tjera financiare si sigurimi, administrimi i portofolit dhe shërbimet komisionere.

---

[6] Sipas citimit në Galac Tomislav, Kraft Evan, "*What has been the impact of foreign bank in Croatia?*", seria e vrojtimeve S-4, December 2000, botim i Bankës Kombëtare të Kroacisë, fq. 1-2. Bonin P. John, Mizsei Kalman, Szekely P. Istvan, Wachtel Paul, "*Banking in transition Economies*", fq. 57 - 76.

* *Mjedisi konkurrues*. Bankat e huaja që hyjnë në treg automatikisht çojnë në rritje të numrit të bankave, pra ka më shumë konkurrencë, megjithëse jo gjithmonë vërehet një fenomen i tillë për shkak të segmentimit të tregut.

* *Zhvillimi i tregjeve financiare*. Bankat e huaja mund të ndihmojnë në thellimin e tregut ndërbankar dhe në tërheqjen e klientëve, që në kushte të tjera ose do të bëheshin klientë të bankave jashtë vendit të tyre ose nuk do të afroheshin fare në sistemin bankar.

* *Prezantimi, qoftë edhe i kufizuar, i praktikave të mira bankare*. Bankat e huaja sjellin në tregun bankar vendas ekspertizën e tyre nëpërmjet personelit të huaj ose nëpërmjet zbatimit të praktikave bankare të vendit të tyre.

* *Tërheqja e investimeve të huaja direkte*. Prania e bankave të huaja, në vetvete, përfaqëson investime të huaja direkte për një vend. Por, kjo prani rrit elementin e sigurisë për investitorët e huaj dhe mund të tërheqë më shumë investime të huaja direkte, sidomos nga vendet përkatëse.

Arsyet kundër hyrjes së bankave të huaja:

* *Frika nga kontrolli i huaj*. Duke qenë se bankat kryejnë veprimtarinë e pranimit të depozitave dhe të dhënies së kredive, veprime që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe në mirëqenien e qytetarëve të tij, pa dyshim që krijohet një situatë frike kur këto aktivitete të rëndësishme janë në duar të të huajve.

* *Industria bankare konsiderohet si industri e sapolindur*. Në vendet me tregje të pazhvilluara, industria bankare është e ngjashme me një industri të sapolindur. Për pasojë argumentohet që ka nevojë të mbrohet deri sa të arrijë të konsolidohet dhe të jetë në gjendje të konkurrojë.

* *Bankat përfaqësojnë një aktivitet të veçantë*. Për shkak të rolit të rëndësishëm që kanë bankat në ekonomi, ato janë edhe nën veprimin e rregullave të veçanta apo të mbrojtjeve të veçanta nga ana e shtetit. Kështu

që argumentohet se nuk është e përshtatshme që këto "privilegje" t'i gëzojnë dhe investitorë të huaj.

* *Bankat e huaja kanë objektiva të ndryshme*. Bankat e huaja mund të interesohen për ekonominë e vendit prej nga vinë dhe jo për zhvillimin e ekonomisë ku janë investuar. Për shembull, ato mund të interesohen thjesht për nxitjen e eksporteve të vendit të tyre apo mbështetjen e projekteve të firmave bashkëpatriote. Për më tepër, mund të ndodhë që me depozitat e mbledhura në vendin ku janë të pranishme këto banka të huaja, të financojnë (japin hua) ekonominë e vendit të tyre.

* *Dallimet në nivelin e rregullimit bankar*. Sipas kritereve të BE-së degët apo zyrat përfaqësuese të bankave të huaja mbikëqyren nga autoriteti mbikëqyrës i vendit prej nga vijnë. Mund të ndodhë që shkalla e zhvillimit të këtij procesi të jetë i ndryshëm dhe në rastin më të keq, vendi prej nga vijnë bankat të ketë autoritet mbikëqyrës të pakonsoliduar duke bërë që, një pjesë e sistemit bankar të ketë një monitorim më të dobët e, për pasojë të zhvillojë praktika bankare jo të shëndetshme. Ndërsa në Shqipëri degët e bankave të huaja mbikëqyren nga autoriteti mbikëqyrës, që është banka qendrore.

Por, përveç shqetësimit për hyrjen e bankave të huaja, është e nevojshme të trajtohet një tjetër fenomen. Konkretisht, bëhet fjalë për diversifikimin e origjinës së kapitalit të huaj, që investohet në sistemin bankar shqiptar. Në parim[7] diversifikimi i kapitalit të huaj ka dy ndikime të dobishme:

* Së pari, sjell kultura të ndryshme bankare me interesa të drejtuara në fusha të ndryshme të ekonomisë apo në segmente të ndryshme të tregut të klientëve.

* Së dyti, ul ekspozimin e sistemit bankar ndaj një ekonomie të vetme, duke reduktuar mundësinë e pësimit të goditjeve të jashtme në rast se ekonomia e atij vendi ka probleme.

[7] Baleta Teuta, "*Shkurtimisht sistemi bankar shqiptar më 1998*" Buletini Ekonomik, vëllimi 2, nr. 2, shtator 1999, botim i Bankës së Shqipërisë, fq. 24.

3. PSE VENDET E RAJONIT?

Nëpërmjet këtij materiali synohet të studjohet pikërisht fenomeni i diversifikimit të kapitalit të huaj në sistemin bankar për rajonin e Ballkanit. Arsyet që na shtyjmë të përqendrohemi në një objektiv më të ngushtë si nga pikëpamja gjeografike (pra nuk merret në shqyrtim gjithë Europa Lindore e Qendrore) ashtu edhe nga pikëpamja problematike (pra nuk shqyrtohet fenomeni i pranisë së kapitalit të huaj në sistemin bankar) është që të studjohet nëse sistemet bankare të këtij rajoni janë ballafaquar me përqendrim të kapitalit nga pikëpamja e origjinës, gjë që i bën ato bashkërisht të ekspozuara ndaj një apo dy ekonomive.

Vendet e Ballkanit, pavarësisht nga disnivelet midis tyre, janë përgjithësisht vende me ekonomi jo të zhvilluar dhe mbi të gjitha me mungesë qëndrueshmërie politike, që në dhjetë vitet e fundit është shndërruar në konflikte të armatosura brenda vendeve dhe midis tyre. Kështu, ato paraqiten jo shumë të përshtatshme për të tërhequr investitorë të huaj. Kjo bën që investimet e huaja në këtë rajon, për momentin, të realizohen nga ekonomi apo investitorë të veçantë, që i kanë të kufizuara mundësitë e investimit në rajone të tjera dhe për pasojë pranojnë një rrezik më të lartë. Teorikisht, investitorët potencialë për Ballkanin do të ishin Italia, Greqia dhe Turqia si vende gjeografikisht të afërta dhe që, në aspektin ekonomik janë më të zhvilluara, pra kanë potenciale investuese. Njëkohësisht, Italia dhe Greqia janë dy vende, që në rajonin e Ballkanit "luajnë" me kartën e vendeve anëtare të BE-së, gjë që "u jep më shumë prestigj në sytë e ekonomive të Ballkanit të cfilitura nga lufta ". Penetrimi i konsiderueshëm i një apo dy ekonomive çon vetvetiu në rritje të shkallës së ekspozimit të çdo vendi ballkanik ndaj tyre, ekspozim i cili shtohet kur këto ekonomi janë të përhapura në të gjithë rajonin.

Për këtë arsye, sistemet bankare janë trajtuar nga dy këndvështrime: ligjor dhe shifror. Së pari, trajtohen aspekte ligjore dhe rregullative, që kanë të bëjnë me hyrjen e bankave të huaja në tregjet bankare të çdo vendi duke ofruar një krahasim midis tyre dhe me standarded e Komitetit të Bazelit. Së dyti, trajtohen treguesit që ofron aktiviteti bankar. Ndonëse në vijim do të përdoret termi "rajon apo rajon ballkanik", në realitet janë shqyrtuar gjashtë vende: Sllovenia, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Rumania, Maqedonia dhe Shqipëria.

4. ASPEKTET LIGJORE

4.1 Respektimi i parimeve bazë të BIS Bazel[8] në fushën e licencimit.

25 parimet bazë të zhvilluara të Bazelit për të siguruar një mbikëqyrje efektive, siç dihet, përfaqësojnë kriteret minimum standarde ndërkombëtare të cilave i referohet autoriteti mbikëqyrës i çdo vendi. Në mënyrë të vazhdueshme theksi vihet mbi respektimin e këtyre kritereve, të cilat trajtojnë të gjitha aspektet e aktivitetit mbikëqyrës. Vend të veçantë në këto standarde kanë parimet, të cilat trajtojnë aspektet e licencimit bankar.

Respektimi i standardeve ndërkombëtare për procesin e licencimit është një element, i cili ndikon në hyrjen e kapitalit të huaj në një vend. Më poshtë po bëjmë një krahasim midis standardeve minimum dhe shkallës së plotësimit të tyre në kërkesat për licencim, të miratuara në vendet që studjohen.

Box 1 : Parimet bazë të BIS Bazelit në fushën e licensimit.

Parimi 2. Veprimtaritë e lejueshme për institucionet, të cilat janë të licencuara dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes si banka, duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe përdorimi i fjalës "bankë" në emërtim duhet të kontrollohet sa më shumë të jetë e mundur.

Parimi 3. Autoriteti licencues duhet të ketë të drejtën të vendosë kritere dhe të mos pranojë kërkesa për krijim bankash, të cilat nuk përmbushin standarded e vendosura. Procesi i licencimit, në minimum, duhet të përbëhet nga vlerësimi i strukturës së pronësisë, drejtorëve dhe administratorëve të tjerë të lartë, plani i veprimtarisë dhe kontrollet e brendshme si dhe parashikimi i situatës financiare, duke përfshirë bazën kapitale; kur pronari i propozuar ose organizata-mëmë është një bankë e huaj, duhet të përftohet më parë leja nga autoriteti mbikëqyrës përkatës.

[8] "*Core Principles for Effective Banking Supervision*", consultative paper issued by the Basle Committee on Banking Supervision, Basle, April 1997.

Veprimtaritë e lejueshme të bankave, që licencohen dhe mbikëqyren duhet të jenë përcaktuar qartë.

Në të gjitha legjislacionet e vendeve të analizuara, jepen përcaktime të qarta të llojit të aktiviteteve, që lejohen të kryejnë bankat e licencuara, duke filluar nga pranimi i depozitave dhe dhënia e kredive, deri tek tregtimi i derivativëve, aktivitetet e kujdestarisë, operimi i sistemit të pagesave etj..

Autoritetet licencuese duhet të kenë të drejtën të vendosin kriteret dhe të mos pranojnë kërkesat, në rast të mosplotësimit të kritereve të licencimit.

Legjislacionet e vendeve përkatëse, kanë të parashikuara, në mënyrë të detajuar, kriteret e vendosura për licencim, kohën e shqyrtimit të kërkesave (që ndryshon sipas vendeve – shih tabelën 2) dhe heqjen e licencës dhe të drejtën e apelimit të të interesuarve.

Minimumi i kritereve që duhet të plotësohen duhet të përfshijnë vlerësimin e strukturës së pronësisë së bankës, drejtorëve dhe administratorëve të tjerë të lartë të bankës, planin e veprimtarisë dhe kontrollet e brendshme, parashikimin e aituatës financiare, përfshi kapitalin bazë; në rastin e bankave të huaja, edhe pëlqimi i mbikëqyrësit të vendit-mëmë.

Në rregullat e licencimit është parashikuar që aksionerët e më shumë se 10 (ndërsa në Bosnje ky tregues është 15) për qind të votave (ose me të drejta të rëndësishme vote) duhet të provojnë se kanë aftësi të mjaftueshme financiare dhe përvojë të përshtatshme biznesi. Në lidhje me situatën financiare të bankave si dhe me mbikëqyrjen e vazhdueshme të vetë bankave, janë përpiluar rregulla të detajuara (rregullat mbi investimet e bankave, shkallën e ekspozimit të tyre etj.).

Kur organi licencues dhe ai mbikëqyrës janë të ndryshëm, duhet të sigurohet bashkëpunim i ngushtë midis tyre.

Në procedurat e licencimit të bankave të huaja ose të degëve të tyre, në të gjitha legjislacionet, parashikohet kërkesa mbi marrjen e pëlqimit nga organi licencues dhe mbikëqyrës i vendit-mëmë. Me përjashtim të Bosnjes[9], organi licencues dhe mbikëqyrës në të gjitha vendet e analizuara është vetë banka qendrore.

Mbikëqyrësit e bankave duhet të kenë autoritetin të shqyrtojnë dhe të hedhin poshtë çdo propozim, lidhur me transferimin e një pjese të rëndësishme të pronësisë ose të interesit kontrollues, palëve të tjera.

Edhe këto kritere janë mbajtur në konsideratë nga legjislacionet kombëtare. Përqindjet përgjithësisht ndryshojnë nga 5 në 10. Në të gjitha rastet, ndryshimet në strukturën e pronësisë së bankave janë subjekt i miratimeve nga autoritetet licencuese.

Mbikëqyrësit e bankave duhet të kenë autoritetin të vendosin kritere për planet e shkrirjes ose të investimeve nga një bankë dhe të sigurojnë se strukturat ose filialet e shkrira nuk e vënë bankën para rreziqeve ose pengojnë mbikëqyrjen.

Edhe kjo kërkesë është e zhvilluar në legjislacionet e kombëtare dhe për çdo rast, kërkohet miratimi nga organi mbikëqyrës dhe licencues.

Në tërësi, ajo që vërehet nga shqyrtimi i legjislacioneve të të gjitha vendeve të marra në analizë, është një lloj uniformiteti në mënyrën e hartimit të ligjeve, të klauzolave të parashikuara (qoftë për kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar për licencim, rregullat e investimit etj.). Legjislacionet parashikojnë detyrimin e bankave për dhënie informacioni, detyrimet për botimin e të dhënave financiare dhe informacionit bankar që është publik (si normat e interesave për depozitat, kredinë etj.).

[9] Në Bosnje, licencimi dhe mbikëqyrja bëhet nga Agjencia Bankare e Bosnjes. Legjislacioni për krijimin e Agjencisë dhe ai për bankat dhe veprimtarinë bankare, parashikojnë klauzola që garantojnë bashkëpunimin mes Bankës Qendrore dhe Agjencisë.

Të gjitha vendet parashikojnë masa specifike (gjoba deri në heqjen e licencës) që autoriteti mbikëqyrës mund të ndërmarrë ndaj bankave në rast të moszbatimit të detyrimeve ligjore.

Nga pikëpamja e kohës së shqyrtimit të kërkesës dhe të pajisjes së subjektit me licencë për ushtrim aktiviteti, intervali luhatet nga 2 muaj në Bosnjë deri në 6 muaj në Bullgari. Ndërsa, nga pikëpamja e kapitalit minimal të kërkuar për ushtrimin e aktivitetit bankar, shuma luhatet në intervalin prej rreth 4.5 - 5 milionë dollarësh (Shqipëri, Slloveni, Bullgari) në 7.2 milionë dollarë për Bosnjen dhe 9.4 milionë dollarë në Maqedoni (kjo shumë në rastin e Maqedonisë i referohet bankave që kryejnë aktivitete me jashtë vendit, si operimin e pagesave, garanci kredish me jashtë etj.). Ligji slloven parashikon që kërkesa për kapital minimal (e cila është e përcaktuar në ligj dhe jo në rregullat e bankës qendrore)[10] ndryshohet nga Banka e Sllovenisë, në rast se kursi i këmbimit të monedhës kombëtare (tolar) ndaj Euro-s do të ndryshojë me më shumë se 10 për qind (sipas kursit të këmbimit të Bankës së Sllovenisë).

Në përgjithësi, kërkesat e licencimit, në aspektet e dokumentacionit të kërkuar, të kohës së shqyrtimit të aplikimeve, të kapitalit minimal të kërkuar dhe të rregullave të tjera mbi investimet dhe mbikëqyrjen, paraqiten homogjene në të gjitha vendet e rajonit dhe, përgjithësisht, në përputhje me standardet minimale ndërkombëtare. Kjo është pasojë e ndikimit, që kanë në ndërtimin e legjislacionit të këtyre vendeve, institucionet ndërkombëtare dhe e prirjes së përgjithshme për t'iu përshtatur standardeve.

Kështu, dallimet janë shumë minore dhe jo të qenësishme për t'i dhënë njerit apo tjetrit vend ndonjë përparësi mbi të tjerët në tërheqjen e kapitalit të huaj apo të origjinave të caktuara të kapitalit të huaj.

Është e qartë që shkalla e depërtimit të bankave të huaja dhe e cilësisë së tyre, më shumë se sa nga klima pro-investitorëve që mund të krijojnë, është

[10] Shqipëria dhe Rumania, në ndryshim nga vendet e tjera, e përcaktojnë shumën minimale të kapitalit në rregullat e licencimit, të miratuara nga banka qendrore, jo në ligj.

rrjedhojë e madhësisë së tregut, stabilitetit ekonomik e politik, shkallës së hyrjes së investitorëve të huaj në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe vetë zhvillimit të kulturës së marrëdhënieve me bankat.

Tabela 2: Krahasimi i kërkesave për licencimin e bankave.

	Shqipëri	Maqedoni	Bullgari	Rumani	Slloveni	Bosnje
Koha e licencimit (në muaj)	3	3	6	4		2
Kapitali minimal i shprehur në milionë njësi të:						
Monedhës kombëtare	700 (lekë)	9 euro	10 000 (leva)		1 000 (tolar)	15 marka të konvertueshme
Monedhës amerikane	5	10	5		4.4	7

Shënim: Janë përdorur kurset mesatare të vitit 2000.

4.2 Çështje specifike.

4.2.1. Blerja e aksioneve të bankës.

Blerja e aksioneve kualifikuese (të specifikuar si zotërim direkt ose indirekt në më shumë se një përqindje e caktuar të pronësisë – që, përgjithësisht, varion nga 5 në 10 për qind) të një banke, kërkon leje nga autoritetet licencuese. Leja do të kërkohet edhe në rastet kur përqindja e pjesëmarrjes së personit (fizik dhe juridik) kërkohet të zgjerohet aq sa personi të bëhet person kontrollues i bankës.

4.2.2. Licencimi i degëve të bankave të huaja.

Në rastin e hapjes së degëve të bankave të huaja ose të zyrave të përfaqësimit, veç dokumentacionit që kërkohet për hapjen e një banke, kërkohet dhe dokumentacion shtesë, që konsiston kryesisht në miratimin e autoriteteve të vendit-mëmë, dokumentacionit financiar të veprimtarisë (të audituar) në vendin-mëmë, lejen e ushtrimit të veprimtarisë në vendin mëmë, aktin e themelimit etj.. Degët e bankave të huaja nuk mund të ushtrojnë veprimtari financiare, që nuk i kryen banka-mëmë.

Licenca, një dege të bankës së huaj i jepet vetëm nëse autoriteti në vendin e bankës së huaj, bën mbikëqyrjen mbi baza të konsoliduara (Bullgaria, Maqedonia). Në rastin e degës së bankës së huaj, kërkohet që banka të paraqesë një dokument zyrtar, që konfirmon gatishmërinë e saj për të garantuar, me gjithë pasuritë e saj, pasivet e krijuara nga operimi i degës së bankës (Bosnja). Dega e bankës së huaj duhet të marrë pjesë në sistemin e garantimit të depozitave, në rast se ajo nuk është pjesëmarrëse në këtë skemë në vendin e saj (Sllovenia). Në Shqipëri, nga pikëpamja e kuadrit rregullativ, degët e bankave të huaja konsiderohen banka. Me fjalë të tjera, këto degë i nënshtrohen të njëjtave kërkesa licencimi dhe mbikëqyrjeje si edhe çdo bankë.

5. ÇFARË NA THONË SHIFRAT[11]?

Numri i bankave, që zhvillojnë aktivitet në rajon është i ndryshëm për vende të ndryshme. Po ashtu, e ndryshme është edhe llojshmëria e institucionit që ofron çdo vend. Ato variojnë nga 13 banka (Shqipëria) në 97 (Sllovenia). Por, kjo nuk do të thotë asgjë, sepse popullsitë e vendeve, të cilave u shërbejnë bankat, niveli i zhvillimit ekonomik, kultura e marrëdhënieve me bankat, gjithashtu, janë të ndryshme.

Tabela 3: Numri i bankave (1999).

Lloji i bankës	Shqipëri	Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Sllloveni	Maqedoni
1. Banka tregtare	10	61	34	28	25	22
2. Kooperativa krediti					68	
3. Banka kursimesh		1			6	16
4. Degë të bankave të huaja	3		7	7		1

Tabela 4: Numri i bankave (2000).

Lloji i bankës	Shqipëri	Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Sllloveni	Maqedoni
1. Banka tregtare	10	56	33	28	25	21
2. Kooperativa krediti					68	
3. Banka kursimesh						19
4. Degë të bankave të huaja	3	7	7	7	4	1

Për të siguruar një krahasim mbi shkallën e përhapjes së shërbimeve bankare në një vend, llogaritet treguesi i numrit të bankave për njëqindmijë banorë.

[11] Analiza e treguesve bëhet për dy periudha, fundi i vitit 1999 dhe shtatori i vitit 2000. Sa herë që në pikën 5 i referohemi vitit 2000 kjo nënkupton shtator 2000.

Tabela 5: Numri i bankave për njëqindmijë banorë.

	Shqipëri	Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Slloveni	Maqedoni
1999	0.38	1.88	0.18	0.42		1.86
Shtator 2000	0.38	1.91	0.17	0.42		1.05
Popullsia (në milionë banorë)*	3.4	3.3	22.5	8.31		2.1

Shënim: Shifrat e popullsisë i përkasin vitit 1998. Burimi: European Business Conspectur, 2001 "Business without borders".

Shihet fare qartë që përqendrimi më i lartë i bankave është në Bosnje Hercegovinë dhe Maqedoni. Me fjalë të tjera, në këto dy shtete ka më shumë banka për t'i shërbyer popullsisë përkatëse të tyre. Shqipëria qëndron në nivelin modest prej 0.38. Një supozim i parë që mund të bëhet, thjesht nga leximi i këtij treguesi, është që Shqipëria ka pak banka, në tregun bankar shqiptar nuk ka konkurrencë. Në polin tjetër gjenden Maqedonia dhe Bosnje-Hercegovina.

Megjithatë, ky tregues duhet të interpretohet duke patur parasysh edhe faktorin e trashëgimisë. Vendet e rajonit, që merren në shqyrtim, i përkasin pa përjashtim vendeve ish-socialiste. Në këtë sistem ekonomik roli i bankave në ekonomi ishte pasiv. Disa vende kishin krijuar një sistem relativisht të gjerë bankar (me shumë banka) e disa të tjera jo. Këto banka u trashëguan dhe janë në proces reformimi. Vite më pas, mund të ndodhemi në situata të përmbysura për shkak të procesit të likuidimit dhe bashkimit të bankave. Shqipëria trashëgoi nga e kaluara vetëm dy banka, prej të cilave njëra u likuidua, dhe një institut kursimi dhe sigurimi. 10 bankat e tjera përfaqësojnë banka të huaja të çelura pas vitit 1992.

Për të realizuar një interpretim të saktë të këtij treguesi ka nevojë që, përveç trajtimit te kritereve licencuese (shih pikën 4) të përqendrohemi në peshën, që ka kapitali i huaj në sistemet bankare. Struktura e pronësisë së kapitalit në sistemin bankar në gjashtë vendet e studjuara jep pamje të

ndryshme. Të dhënat flasin për peshë të ulët të pronësisë shtetërore në sistemin bankar të Maqedonisë dhe Shqipërisë, peshë e cila është reduktuar më tej në shtator të vitit 2000, krahasuar me vitin 1999 si pasojë e privatizimit. Edhe Bullgaria paraqet ndryshim të ndjeshëm strukturor duke reduktuar peshën e pronësisë shtetërore nën supozimin që kjo është bërë nën ndikimin e privatizimit dhe/ose likuidimit të bankave shtetërore. Përsa i përket hyrjes së kapitalit të huaj vërehen:

- rritje e peshës së kapitalit të huaj gjatë vitit 2000 krahasuar me vitin 1999, sidomos në Bullgari, Maqedoni e Shqipëri;
- prani më e lartë e kapitalit të huaj në Shqipëri, me 87.4 për qind (në shtator 2000) të kapitalit gjithsej të sistemit bankar;
- prani më e ulët e kapitalit të huaj në Slloveni dhe Bosnje-Hercegovinë, me përkatësisht 11.3 për qind (viti 1999) dhe 16.5 për qind (shtator 2000) të kapitalit gjithsej të sistemit bankar.

Në bazë të këtij treguesi për Shqipërinë mund të supozohet se është vendi:

- Relativisht më i preferuar për investime të huaja në fushën bankare.
- Relativisht "më dashamirës" në lejimin e hyrjeve të bankave të huaja.
- Relativisht me nivel të konsiderueshëm të privatizimit të bankave shtetërore.

Ndërkohë, për sistemin bankar shqiptar nuk mund të thuhet se ka krietere më liberale në licencim, pasi krahasimi i bërë me kërkesat e vendeve të tjera dhe me standardet, nxjerr në pah vetëm ndryshime të lehta dhe pa ndikim të madh.

Siç u përmend më sipër, niveli më i ulët i hyrjes së kapitalit të huaj vërehet në Slloveni. Ndoshta, kjo është rrjedhojë e strategjisë së ndjekur nga ky vend. Sipas Galac dhe Kraft (2000)[12]: "Një version më i pranueshëm i argumentit pro industrisë së sapolindur është të mbështetet formimi i bankave ose i grupeve të bankave të forta vendase nëpërmjet bashkimeve, ndoshta me ndihmën e qeverisë, në vend të privatizimit nëpërmjet investitorëve të huaj strategjikë. Stiblar (1999) përpunon një strategji të tillë për Sllovenínë. Megjithatë, ende nuk është e qartë nëse një strategji e tillë do të funksionojë në një mjedis të hapur, konkurrues, duke ditur përparësitë e shumta që gëzojnë bankat e huaja në teknologji, fuqi financiare dhe ekspertizë. Të tilla përpjekje u abandonuan në Poloni".

Tabela 6: Struktura në përqindje e pronësisë së kapitalit në sistemin bankar (1999).

Llojet	Shqipëri	Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Slloveni	Maqedoni
1.Shtetërore	37.3	44.2	42.6	41.1	44.4	6.5
2. Private vendase	0.0	41.5	17.8	19.1	47.3	82.1
3. Të huaja	62.7	14.3	39.6	39.8	11.3	11.4

Tabela 7: Struktura në përqindje e pronësisë së kapitalit në sistemin bankar (shtator 2000).

Llojet	Shqipëri	Bosnje/ Hercegovina*	Rumani	Bullgari	Slloveni**	Maqedoni
1.Shtetërore	12.6	44.6	50.0	14.1		5.5
2. Private vendase	0.0	38.9	9.3	16.4		54.2
3. Të huaja	87.4	16.5	40.7	69.5		40.3

Shënime: * Të dhënat i përkasin qershorit të vitit 2000.

** Ky tregues llogaritet një herë në vit.

[12] Galac Tomislav, Kraft Evan, "*What has been the impact of foreign bank in Croatia?*", seria e vrojtimeve S-4, December 2000, botim i Bankës Kombëtare të Kroacisë, fq. 2.

5.1 Diversifikimi i kapitalit të huaj.

Siç e theksuam më sipër, për sistemin bankar të një vendi ka rëndësi thithja e kapitalit të huaj me origjinë të diversifikuar për të shmangur sa më shumë ekspozimin ndaj një ekonomie të vetme. Për të matur shkallën e diversifikimit, për sistemet bankare të gjashtë vendeve në studim është llogaritur pesha, që zë kapitali i klasifikuar sipas origjinës. Për bazë janë marrë ekonomi, të cilat mendohet se kanë interes të investojnë në sistemet bankare të vendeve të rajonit pasi janë të afërta gjeografikisht ose si pasojë e lidhjeve tradicionale me këtë rajon.

Tabela 8: Diversifikimi i kapitalit (në përqindje ndaj kapitalit gjithsej të sistemit bankar) (viti 1999).

Origjina e kapitalit	Shqipëria		Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Slloveni	Maqedoni
	1999	2000					
1.Grek	24.1	31.6		2.8			
2. Italian	4.4	4.9					
3. Turk		12.3	4.7	3.6			4.7
4. Austriak			4.6	1.6		6.2	
5. Gjerman	2.6	3.0	1.0				
6. Të tjera	31.6	35.6		15.7		0.5	6.7

Vërehet që kapitali turk ka një shtrirje relativisht më të gjerë në vendet e rajonit (në katër prej tyre) ku peshën më të lartë e ka në Shqipëri. Në tri vende rezulton të ketë investuar kapitali austriak dhe në dy ai gjerman, por pesha e tyre është reltivisht e ulët, nuk kalon as 5 për qind. Dy vende deklarojnë se kanë investime të kapitalit grek, Shqipëria dhe Rumania. Megjithatë, është fakt i njohur që edhe në Bullgari e Maqedoni ka investim grek në sistemin bankar (shih Box. 2), megjithëse nuk u mundësua sigurimi i të dhënave. Por, në lidhje me shtrirjen e kapitalit grek vërejmë një karakteristikë të ndryshme. Në sistemin bankar shqiptar ky kapital ka peshë të konsiderueshme (rreth 1/3 e kapitalit të sistemit

bankar). Përsa i takon kapitalit italian vetëm Shqipëria deklaron të ketë të tillë, por me peshë të ulët.

Box 2: Penetrimi i bankave me kapital grek në vendet e Ballkanit.

I. Bullgari[13]:

Në maj 2000, Banka Kombëtare e Greqisë (NBG), grupi më i madh bankar i vendit, bleu 90 për qind të United Bulgarian Bank (një ndër bankat më të mëdha tregtare) me një shumë prej 229 milionë euro. BERZH do të marrë 10 përqindshin e mbetur. Çmimi i blerjes arriti (zyrtarisht) në 200 milionë dollarë amerikanë. EFG Eurobank (krahu i grupit Zviceran EFG në Greqi) bleu 78 për qind (për 38 milionë dollarë amerikanë) të aksioneve të Postbank (në partnership me Alico, kompania e sigurimeve e AIG).

II. Maqedoni[14]:

Banka Kombëtare e Greqisë bleu 65 për qind të aksioneve të bankës më të madhe shtetërore Stopanska Banka, për 117 milionë marka gjermane.

Alpha Bank bleu 65 për qind të Creditna Banka, bankës më fitimprurëse në Maqedoni, për 18.5 milionë dollarë amerikanë. Kjo bankë parashikohet të merret me transfertat e dërgesave të emigrantëve shqiptarë dhe të organizatave ndërkombëtare që punojnë në Prishtinë.

III. Rumani[15]:

Alpha Bank ka hapur një filial të saj, Banca Bucuresti. Pireaus Bank ka blerë Pater Bank (5.5 milionë dollarë amerikanë). EFG Eurobank ka blerë Bank Post (pjesën e aksioneve strategjike). Banka Kombëtare e Greqisë, gjithashtu, ka çelur një degë në këtë vend.

IV. Shqipëri:

Banka Kombëtare e Greqisë, Alpha Bank dhe Banka Tregtare kanë çelur përkatësisht degët e tyre. Ndërsa, Tirana Bank është filial i Grupit Piraeus. Këto banka veprojnë në Shqipëri që nga viti 1996.

[13] "The Banker", July 2000.
[14] Iden.
[15] "The Banker", July 2000 dhe "Romanian Business Journal", nr. 2 (92), 12-16 janar, 1996 dhe "New Europe", 10-16 maj, 1998.

Box 3: Banka Kombëtare e Greqisë.

Banka Kombëtare e Greqisë[16], banka më e madhe tregtare e Greqisë, kërkon të bëhet një bankë me përmasa rajonale në Europën Juglindore dhe Mesdheun Lindor. Prova për këtë është çelja e degëve në Sofje (Bullgari), Tiranë, Shqipëri dhe në Bukuresht (Rumani).

Po punohet edhe për çeljen e degëve në Beograd, si edhe në qytetin juglindor të Shqipërisë, Korçë, qyteti i cili është afër kufijve me Greqinë dhe FYROM, dhe në Durrës, një qytet-port rreth 45 km në perëndim të Tiranës.

5.2 Roli i bankave me kapital të huaj.

Për të kuptuar rolin apo peshën që kanë bankat me kapital të huaj në sistemin bankar të vendeve të rajonit jemi përqendruar në disa tregues. Konkretisht është parë se ç'peshë kanë bankat sipas origjinës së kapitalit, në lidhje me aktivitetin gjithsej të tyre (totali i aktiveve), aktivitetin huadhënës dhe atë të pranimit të depozitave, që janë dy funksionet bazë të një banke tregtare.

Tabela 9: Pesha sipas totalit të aktiveve (në përqindje ndaj aktiveve gjithsej të sistemit bankar) (viti 1999).

Origjina e kapitalit	Shqipëri		Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Slloveni	Maqedoni
	1999	2000					
1.Grek	7.2	11.1		2.3			
2. Italian	5.0	6.0					
3. Turk		12.7		5.9			1.2
4. Austriak				2.5		4.5	
5. Gjerman	1.0	1.6					
6. Të tjera	5.5	7.6		23.7		0.4	7.6

[16] "*National Bank of Greece is setting its sighs high*", "New Europe", 10-16 maj, 1998.

Tabela 10: Pesha sipas tepricës së huave (në përqindje ndaj huave gjithsej të sistemit bankar) (viti 1999).

Origjina e kapitalit	Shqipëri		Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Slloveni	Maqedoni
	1999	2000					
1.Grek	7.2	11.9		3.3			
2. Italian	16.4	21.8					
3. Turk		36.3		3.6			
4. Austriak				2.4		4.0	
5. Gjerman	3.6	5.5					
6. Të tjera	4.2	6.2		29.1		0.5	8.5

Tabela 11: Pesha sipas depozitave (në përqindje ndaj depozitave gjithsej të sistemit bankar) (viti 1999).

Origjina e kapitalit	Shqipëri		Bosnje/ Hercegovinë	Rumani	Bullgari	Slloveni	Maqedoni
	1999	2000					
1.Grek	6.3	9.0		1.2			
2. Italian	4.2	4.7					
3. Turk		9.8		7.0			0.5
4. Austriak				1.9		3.4	
5. Gjerman	0.9	1.5					
6. Të tjera	3.8	6.2		21.1		0.2	6.1

Në tërësi, bie në sy që roli që luajnë bankat e huaja në sistemet bankare të vendeve të rajonit, nga pikëpamja e zgjerimit të aktivitetit, nuk është i konsiderueshëm si në aktivitetin kreditues e depozitues ashtu dhe në veprimtarinë gjithsej. Në të gjitha vendet e rajonit ka njëlloj harmonie midis treguesve, në kuptimin që treguesit relativë (ata që paqyrojnë peshën në sistemin bankar sipas aktiviteteve të ndryshme) janë të afërt në vlera me njëri-tjetrin, si për të gjitha bankat e huaja ashtu edhe sipas origjinës së kapitalit.

Në të kundërt, Shqipëria paraqet një disnivel të lartë. Nëse në vitin 1999 pesha e kapitalit të huaj është 62.7 për qind, peshat e aktivit gjithsej, huave dhe depozitave arrijnë në përkatësisht 18.7, 31.4 dhe 15.2 për qind. Për vitin 2000

këta tregues, në pamje të parë, përmirësohen pasi shtimi i peshës së kapitalit në 87.4 për qind, shoqërohet me shtim të peshës së aktivitetit gjithsej, të huave dhe depozitave në përkatësisht 39, 81.7 dhe 31.2 për qind. Megjithatë, ky pohim nuk është shumë real pasi në këtë vit kemi privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare, e cila trashëgoi aktivitetin e kësaj banke qysh kur ajo ishte shtetërore.

Disniveli, në rastin e Shqipërisë, është akoma më i theksuar nëse bankat e huaja shqyrtohen sipas origjinës së kapitalit. Kështu, sipas të dhënave të vitit 2000, bankat me kapital grek zënë 1/3 e kapitalit të sistemit bankar, por afër 1/10 e aktivitetit gjithsej, atij kreditues e depozitues. Kapitali italian përbën vetëm 5 për qind të kapitalit gjithsej të sistemit bankar, po zë rreth 1/5 e aktivitetit kreditues. Ndërsa, kapitali gjerman zë 3 për qind të kapitalit gjithsej të sistemit bankar dhe 5.5 për qind të aktivitetit kreditues. Aktiviteti gjithsej dhe ai depozitues janë të afërta me nivelin e peshës së kapitalit. Kjo evidenton dy sjellje të ndryshme bankash. Banka Italo-Shqiptare dhe deri diku FEFAD (pjesërisht me kapital gjerman) kanë sjellje "më normale", duke u zgjeruar relativisht në masë të konsiderueshme në kreditim, aktivitet i cili financohet si nga kapitali i vet i bankës, ashtu edhe nga depozitat. Ndërsa, grupi i bankave greke paraqitet më konservator në këtë drejtim. Ai është i kufizuar në kreditimin e ekonomisë shqiptare.

6. KONKLUZIONE

1. Në përgjithësi, kërkesat për licencimin e bankave janë të ngjashme midis vendeve të studjuara. Ato, gjithashtu, respektojnë kriteret standarde ndërkombëtare të parashikuara në parimet bazë të BIS Bazelit. Dallimet që evidentohen janë shumë minore dhe jo të qenësishme për t'i dhënë njërit apo tjetrit vend ndonjë avantazh mbi të tjerët, në tërheqjen e kapitalit të huaj apo të origjinave të caktuara të kapitalit të huaj. Është e qartë që ka të tjera motive, të cilat nxisin kapitalin e huaj në sistemet bankare të vendeve të rajonit.

2. Nga analizimi i strukturës së pronësisë vërehet që kapitali turk ka shtrirje më të gjerë gjeografike (e raportojnë më shumë vende). Nëse nuk i qëndrojmë strikt shifrave të ofruara, por marrim parasysh informacionin e ofruar nga gazetat dhe periodikët e cituar, në rajonin e Ballkanit janë zgjeruar në masë të njëjtë (si numër vendesh) bankat me kapital turk dhe grek. Por, kapitali grek paraqitet më i përqendruar (me peshë më shumë) në pak vende, sidomos në Shqipëri. Ndryshe nga ç'pritej Italia nuk është e pranishme në masë të konsiderueshme.

3. Shqipëria ka shkallën më të lartë të hyrjes së kapitalit të huaj në vend për sistemin bankar, por kjo vjen nga numri i vogël i bankave të trashëguara dhe nga stadi më i përparuar i privatizimit të bankave (edhe sepse ka pak banka për t'u privatizuar), jo si pasojë e kritereve më liberale për licencimin e tyre. Megjithatë, kjo situatë mund të jetë dhe tregues i një qëndrimi "më dashamirës" në lejimin e hyrjes së bankave të huaja.

4. Shqipëria ka numrin më të vogël të bankave për banorë, pra një sistem bankar jo shumë konkurrent.

5. Bankat e huaja kanë peshë relativisht të ulët në aktivitetin e sistemeve bankare të vendeve të rajonit. Megjithatë, nëse në vendet e tjera të rajonit kemi një paraqitje harmonike të treguesve, në Shqipëri ka disnivel. Bankat e huaja kanë depërtuar ndjeshëm në sistemin bankar shqiptar nga pikëpamja e kapitalit, por roli që luajnë në aktivitetin bankar është i kufizuar. Më tipike kjo karakteristikë është për grupin e bankave greke.

Në përfundim, për autoritetet shqiptare do të propozonim si politikë të vlefshme lejimin e hyrjes së bankave të reja në tregun shqiptar. Megjithatë, dukshëm paraqitet i domosdoshëm krijimi i bankave me kapital shqiptar, diversifikimi i origjinës së bankave të huaja, hartimit të politikave të licencimit si dhe një studim më i mirë i planeve të bizneseve dhe ndjekje e realizimit të tyre edhe pas fillimit të aktivitetit, me qëllim që bankat e huaja të luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe të sistemit bankar. Privatizimi i Bankës së Kursimeve ofron një shans mjaft të mirë për të thelluar diversifikimin e kapitalit të huaj të investuar në sistemin bankar shqiptar. Me interes do të ishte që puna kërkimore për këtë çështje të thellohet më tej në drejtim të vlerësimit të efektit, që kanë patur bankat e huaja në sistemet bankare të vendeve të rajonit. A ka qenë ky efekt pozitiv dhe a ka qenë në nivelin e pritshëm?

7. BIBLIOGRAFIA.

Buletine ekonomike të Bankës së Shqipërisë.

Baleta Teuta, "*Shkurtimisht sistemi bankar shqiptar më 1998*" Buletini Ekonomik, vëllimi 2, nr. 2, shtator 1999, botim i Bankës së Shqipërisë.

Bonin P. John, Mizsei Kalman, Szekely P. Istvan, Wachtel Paul, "Banking in transition Economies". EE, 1998.

“Core Principles for Effective Banking Supervision”, Consultative paper issued by the Basle Committee on Banking Supervision, Basle, April 1997.

Galac Tomislav, Kraft Evan, "*What has been the impact of foreign bank in Croatia?*", seria e vrojtimeve S-4, December 2000, botim i Bankës Kombëtare të Kroacisë.

"*National Bank of Greece is setting its sighs high",* "New Europe" 10 - 16 maj, 1998.

"*Romanian Business Journal*" nr. 2 (92), 12 - 16 janar, 1996.

Rregullat e licencimit të Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Sllovenisë dhe Rumanisë.

"The Banker", "Starting from scratch" dhe "Survey finds foreign ownership is rising", October 1999.

"The Banker", July 2000.